

## 12.6 OBJEKTET E LIDHURA

Është pjesë e dritares së shfletuesit, në të cilën paraqiten objektet e lidhura me regjistrimin e përzgjedhur.

Në klasën **Regjistrimi bibliografik** janë të shtuara këto lidhje:

- nga regjistrimi për artikullin në regjistrimin për burimin
- nga regjistrimi për burimin në vazhdim në regjistrimin për burimet e lidhura në vazhdim
- nga regjistrimi për monografinë, përkatësisht regjistrimi për burimin në vazhdim, në regjistrimin për pjesët përbërëse



Shënim:

*Nëse monografia ose burimi në vazhdim përmban më shumë se 1000 artikuj, përkatësisht pjesë përbërëse, në dritaren **Pjesët përbërëse (nnn)** mund të shfaqen më së shumti 999 regjistrime.*

- nga objekti regjistrimi bibliografik në objektin material, që përdoret për lidhje me aplikacionet lokale.
- nga regjistrimi bibliografik në regjistrimet përkatëse të njësuara
- nga regjistrimi bibliografik i bazës së të dhënave COBIB në regjistrimet arkivore përkatëse
- nga regjistrimi bibliografik në regjistrimet për lidhjet interne nga baza e të dhënave ELINKS

Në klasën **Regjistrimi i njësuar (CONOR)** është shtuar lidhja:

- nga regjistrimi i njësuar në regjistrimet arkivore përkatëse

Në klasën **Regjistrimi i njësuar (SGC)** janë shtuar lidhjet:

- nga regjistrimi i njësuar në regjistrimet arkivore përkatëse
- nga regjistrimi i njësuar në regjistrimet për termat e gjerë
- nga regjistrimi i njësuar në regjistrimet për termat në lidhshmëri
- nga regjistrimi i njësuar në regjistrimet për termat e ngushtë